



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**V E N D I M**

**NR. 3/8, DATË 15 / 07/2021**

**PËR**

**MIRATIMIN E STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT "FERMË AKUAPONI" ME SUBJEKT INVESTUES "AQUATIQ" SHPK NUIS/NIPT L71320011G.**

Në mbështetje të Nenit 9, 17, 18 dhe 21 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

**VLERËSOI:**

- Subjekti aplikues propozon ndërtimin e një Ferme Akuaponike (Ferma), në zonën e Karavastasë, fshatin Adriatik, Bashkia Divjakë, me një sistem me dy nivele, e cila do të ketë si qëllim zhvillimin e aktivitetit të akuaponisë.
- Ky është aplikimi i dytë i subjekti "Aquatiq" sh.p.k., pas atij të vitit 2018, i cili, me Vendim të KIS nr. 4/4, datë 19.04.2018, përfitoi statusin strategjik për një hapësirë prej vetëm 1.3 ha, në Karavasta të Re, në zonën DJ\_B\_EB\_2, duke u vlerësuar pozitivisht, si projekt pilot.
- Vendimi i KIS Nr. 4/4, datë 19.04.2018 nuk u vu në zbatim nga subjekti, pasi projekti u konsiderua si një investim, që do të rritej dhe se zona në fjalë, potencialisht, nuk do ta lejonte zgjerimin e këtij aktiviteti, ndaj dhe subjekti ri-aplikoi në vitin 2020 për një hapësirë

tjetër, prej 146 ha.

- Projekti u shqyrtua nga Grupi Operacional, i cili dha rekomandimet përkatëse, por dosja e aplikimit nuk u përfshi në asnjë rend dite të mbledhjeve të KIS përgjatë vitit 2020, pasi, paralelisht me aplikimin e subjektit, për zonën e Karavastasë kanë qenë në proces shqyrtimi e vendimmarrje edhe projekte të tjera, ashtu sikurse pritej edhe miratimi dhe zbardhja e vete PDZRK Karavasta.
- Projekti aktual synon zhvillimin e një zone prej 146 ha, në parcelat e zonës DJ\_B\_B\_1, Karavasta e Re. Zhvillimi synon të përfshijë disa faza, ku faza e parë pritet të jetë ajo e ndërtimit të fermës filestare prej 12.25 ha, e cila përbëhet nga disa zona prodhimi (2.57 ha secila zonë) dhe po kështu edhe sipërfaqet e fermave pasardhëse.
- Vlera e këtij investimi parashikohet që të shkojë afërsisht € 26,000,000 (njëzet e gjashtë milion) Euro.
- Projekti plotëson kriteret e punësimit të kërkuara nga legjislacioni për investimet strategjike, duke parashikuar të punësojë 1500 persona.
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural konfirmon parcela të lira në zonën e kërkuar, pra DJ\_B\_B\_1, Karavasta e Re.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

## **KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

### **VENDOSI:**

1. Miratimin e Statusit “Investim/Investitor strategjik procedurë e asistuar” për projektin e investimit “Fermë Akuaponi”.
2. Projekti “Fermë Akuaponi” do të realizohet nga subjekti "Aquatiq" shpk, me NUIS/NIPT L71320011G.
3. Projekti parashikon realizimin e investimit në sektorin strategjik të bujqësisë.
4. Projekti parashikohet të zhvillohet në zonën e Karavastasë, fshatin Adriatik, Bashkia Divjakë, në ZK 2085.
5. Statusi “Investim/Investitor strategjik procedurë e asistuar” i jepet projektit të investimit

“Fermë Akuaponi”, për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

6. Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, përkatësisht neni 21, neni 23, dhe neni 27 i Ligj Nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, masat mbështetëse që i jepen projektit janë si më poshtë:

- a) Miratohet masa mbështetëse e kryerjes së procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përshpejtuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;
- b) Miratohet masa mbështetëse e asistencës në lidhje me dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e projektit, në përputhje me afatet e parashikuara sipas legjislacionit të investimeve strategjike;
- c) Miratohet në parim masa mbështetëse, konsolidim toke, si dhe dhënie në përdorim të pasurisë së paluajtshme në pronësi të shtetit shqiptar, për zhvillimin dhe realizimin e këtij projekti investimi strategjik, në sipërfaqen prej afërsisht 100 Ha në zonën kadastrale Nr. 2085, nën administrim të MBZHR, respektivisht parcelat 33/1 , 34/1, 35/1 , 36/1 , 37/1 , 38/1 , 39/1 , 40/1 , 40/4 të cilat gjenden në zonën DJ\_B\_B1 sipas Vendimit të KKT nr.3 datë 14.01.2020 të PDZRK-s mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman, i Rishikuar.

Në zbatim të nenit 27 të Ligj Nr. 55/2015, i ndryshuar, miratimi përfundimtar i masës mbështetëse të mësipërme dhe kontratës që do të nënshkruhet për mënyrën e dhënies në përdorim të pronës shtetërore për realizimin e investimit strategjik, do të rregullohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për investimet strategjike.

7. Mënyrat, procedurat, afatet dhe organet zbatuese për ofrimin e masave mbështetëse përcaktohen edhe në planin e veprimit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik “Fermë Akuaponi” konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e veçantë, Komiteti i Investimeve Strategjike ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.

9. Ky vendim i njoftohet investitorit si dhe publikohet në regjistrin e investimeve strategjike.

10. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për të propozuar në Këshillin e Ministrave vendimin për kalimin e pronës shtetërore, të përmendur në pikën 6 (c), më sipër, në fondin e pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike (FPPIS).
11. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për të propozuar në Këshillin e Ministrave vendimin për dhënien në përdorim të subjektit të pasurisë së paluajtshme shtetërore për realizimin e projektit të investimit strategjik "Fermë Akuoponi" në zbatim të legjislacionit në fuqi për pronat e paluajtshme shtetërore.
12. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për të lidhur kontratën e qirasë 1 Euro me subjektin, në zbatim të legjislacionit në fuqi.
13. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për paraqitjen dhe përditësimin e të gjitha ndryshimeve të nevojshme në regjistrin kadastral lidhur me zonën në zhvillim.
14. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për monitorim të realizimit të projektit të investimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**

**ERION BRAÇE**

**MINISTËR I FINANCEVE DHE EKONOMISË**

**ANILA DENAJ**

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

BELINDA BALLUKU

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**

BLENDI KLOSI

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

MILVA EKONOMI

**AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT**

BRUNILDA LILO

**SEKRETARIATI TEKNIK I KIS**

SOKOL NANO

## PLANI I VEPRIMIT

### PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT STRATEGJIK “FERMË AKUOPONI”

#### *1. Përmbajtja e planit të veprimit*

Plani i veprimit për realizimin e një projekti strategjik, përcakton:

- Procedurat lehtësuese që do të zbatohen për realizimin e investimit strategjik dhe afatet e përshpejtuara brenda të cilave duhet të kryhen;
- Shërbimet ndihmëse që do të ofrohen ndaj projektit strategjik;
- Masat mbështetëse që do të nevojiten për mbështetjen e investimit strategjik;
- Organet përgjegjëse për zbatimin e investimit strategjik;
- Detyrat përkatëse për secilin organ të përfshirë në realizimin e investimit strategjik;
- Programin e punës për realizimin e investimit strategjik të detajuar në faza;

#### *2. Zbatimi i planit të veprimit*

Plani i veprimit ndiqet dhe zbatohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e cila koordinon veprimtarinë me organet e tjera shtetërore dhe me investitorin.

Autoritetet publike, të përfshira në mënyrë direkte apo indirekte në realizimin e një investimi strategjik, kanë detyrimin ligjor në lidhje me trajtimin me prioritet të procedurave dhe brenda afateve të përshpejtuara. Këto organe kanë detyrimin ligjor që të bashkëpunojnë dhe t'i japin Agjencisë, sqarime, informacione, lejet, licencat, autorizimet, mendimet dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik.

#### *3. Informacione të përgjithshme mbi Planin e Veprimit të projektit “Fermë Akuoponi”*

Ky plan veprimi për realizimin e Projektit të Investimit “*Fermë Akuoponi*”, përcakton masat, procedurat dhe afatet, në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e projektit investues strategjik, në të cilin përcaktohen angazhime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha fazat e realizimit dhe zbatimit të projektit.

Plani i veprimit, u hartua nga grupi operacional i krijuar pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit

të Investimeve, bazuar në karakteristikat e projektit të propozuar. Për këtë qëllim, propozuesi i investimit strategjik, ka listuar dhe treguar qartësisht në momentin e paraqitjes së aplikimit, procedurat, shërbimet, dhe masat mbështetëse konkrete, të cilat kërkon të përfitojë nga shteti shqiptar, për realizimin e investimit.

Plani i veprimit u hartua pasi propozimi i paraqitur mbi investimin strategjik të Projektit **“Fermë Akuoponi”** është vlerësuar paraprakisht dhe ka një rekomandim pozitiv të Komitetit të Investimeve Strategjike në lidhje me miratimin e tij. Autoriteti përgjegjës për miratimin e planit të veprimit për çdo projekt strategjik të miratuar është Komiteti i Investimeve Strategjike.

#### ***4. Hapat procedurale***

Propozimi nga investitori:

Investitori "AQUATIQ" shpk, me NUIS/NIPT L71320011G, kur paraqiti projektin e investimit strategjik tek AIDA, në përputhje me legjislacionin ka specifikuar edhe listën e procedurave, shërbimeve dhe masat mbështetëse që kërkon për realizimin e investimit strategjik.

Masat mbështetëse që kanë një vlerësim pozitiv nga KIS janë si më poshtë vijon:

<b>Masat e kërkuara</b>	<b>Rekomandimi</b>	<b>Institucion i përgjegjës</b>	<b>Procedura për masën e kërkuar e detajuar në faza. Detyrimet sipas institucioneve përgjegjëse</b>	<b>Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë subjekti</b>	<b>Afati</b>	<b>Kosto</b>

<p>Përdorim të pasurive të paluajtshme shtetërore për realizimin e projektit.</p>	<p><b><u>PO</u></b>  Projekt i investimit të ndihmohet nga Shteti Shqiptar duke i dhënë në përdorim sipërfaqen e kërkuar në zonën kadastrale Nr. 2085, nën administrim të MBZHR, respektivisht parcelat: 33/1 , 34/1, 35/1 , 36/1 , 37/1 , 38/1 , 39/1 , 40/1 , 40/4 , të cilat gjenden në zonën DJ_B_B1 sipas vendimit të KKT nr.3 datë 14.01.2020 të PDZRK-s mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman, i Rishikuar.</p> <p>Do të nënshkruhet gjithashtu në vijim Kontrata e Qirasë me tarifën simbolike 1 Euro, ndërmjet subjektit investues <b>dhe MFE</b> duke i vënë në dispozicion sipërfaqen e kërkuar.</p>	<p><b>MBZHR</b>  <b>MFE</b>  <b>ASHK</b></p>	<p>Referuar VKM Nr. 1030, datë 16.12.2015.</p> <p>MBZHR dhe MFE do të propozojnë në Këshillin e Ministrave, VKM për kalimin e parcelave që do të vihen në përdorim në fjalë në fondin e pasurive te paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike (FPPMIS) sipas VKM Nr. 1030, datë 16.12.2015 pjesa II , si dhe dhënien me qira të këtyre parcelave me tarifën simbolike 1 Euro, subjektit Aquatiq shpk, për realizimin e fermës së Akuaponisë.</p> <p>Kontrata lidhet me MFE sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.</p>			
---	--	--	---	--	--	--



Mbështetje në marrjen e licencave/lejeve/autorizimeve pas përfitimit të statusit “Investitor strategjik, procedurë e asistuar”.	<b><u>PO</u></b>	MIE MBZHR BASHKIA DIVJAKË AIDA			Pas vendimit të KIS	Nuk ka
---	------------------	--	--	--	---------------------	--------

**KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**

**ERION BRAÇE**

**MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË**

**ANILA DENAJ**

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**BELINDA BALLUKU**

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**

**BLENDI KLOSI**

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

MILVA EKONOMI

**AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT**

BRUNILDA LILO

**SEKRETARIATI TEKNIK I KIS**

SOKOL NANO